

20130791767

L I G J
PËR MARRJEN DHE SHKEMBIMIN E DESHMIVE DHE TË DHENAVE
ME DETYRE ZYRTARE

Neni 1

(1) Me kete ligj rregullohet procedura për marrjen dhe shkembimin e deshmive dhe të dhenave me detyre zyrtare nga ministritë, organet tjera të administratës shtetërore, organizatat e percaktuara me ligj, organet tjera shtetërore, personat juridike dhe të tjere, të cilet me ligj ngarkohen që të kryejnë autorizime publike, organet e komunes, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit (në tekstin e metejme: organi kompetent për vendimmarrje), kur në punët administrative, duke i zbatuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë rregullat vendosin për të drejtat, obligimet ose interesat juridike të personave fizike dhe juridike ose të paleve tjera (në tekstin e metejme: palet).

(2) Dispozitat e këtij ligji detyrimisht zbatohen në procedura për vendimmarrje për të drejtat, obligimet ose interesat juridike të paleve.

(3) Me deshmi dhe të dhena sipas këtij ligji, nenkuptohen dokumentet (deshmi, certifikata, vertetime e të tjera), që leshohen nga organi kompetent për të cilat mban evidence zyrtare, e që shërbejnë për percaktimin e gjendjes faktike në baze të së ciles vendoset për të drejtat, obligimet ose interesat juridike të paleve.

Neni 2

(1) Deshmitë dhe të dhenat nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, për të cilat organi kompetent për vendimmarrje mban evidence zyrtare, do të konsiderohet se pala i ka parashtruar me kerkese, e të cilat organi kompetent për vendimmarrje i merr me detyre zyrtare.

(2) Deshmitë dhe të dhenat nga paragrafi (1) i këtij neni, do të konsiderohet se pala i ka parashtruar me kerkese, nese për të njëjtat evidence zyrtare mban organi tjetër, e të njëjtat organi kompetent për vendimmarrje mund t'i marrë me detyre zyrtare, nese pala jep pelqim paraprak që të dhenat personale të saj të perdoren në procedure për realizimin e të drejtës së caktuar ose interesit juridik.

Neni 3

(1) Personi zyrtar i cili e udheheq procedurën, është i detyruar që me detyre zyrtare t'i marrë deshmitë dhe të dhenat për faktet për të cilat evidence zyrtare mban organi kompetent për vendimmarrje.

(2) Personi zyrtar do të veproje në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni edhe në rast kur në lidhje me faktet evidence zyrtare mban organi tjetër shtetëror, perkatesisht subjekti tjetër i cili mban regjister të të dhenave.

(3) Organi shtetëror, perkatesisht subjekti i cili mban evidence zyrtare, është i detyruar që deshmitë dhe të dhenat e kerkuara t'i dorëzojë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kerkeses, nese të dhenat sigurohen në formë elektronike, perkatesisht në afat prej shtatë ditësh në rast se deshmitë dhe të dhenat sigurohen me shkrim.

(4) Personi zyrtar do t'i marrë të dhenat personale për palen e cila ka dorëzuar parashtrëse për ngritjen e procedurës, e të cilat nevojiten për zgjidhjen e kerkeses.

(5) Mënyra e marrjes dhe shkëmbimit të të dhenave nga paragrafi (4) i këtij neni, bëhet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhenave personale.

Neni 4

(1) Pala, kerkesen për realizim të së drejtes, perkatesisht interesit juridik eshte e detyruar që ta dorezoje në formular, në të cilin në menyre taksative shenohen deshmite dhe të dhenat të cilat pala eshte e detyruar t'ia bashkengjite kerkeses dhe të dhenat dhe deshmite të cilat organi kompetent për vendimmarrje i merr me detyre zyrtare.

(2) Formularin e kerkeses nga paragrafi (1) i ketij neni dhe dokumentacionin e nevojshem për realizimin e së drejtes, perkatesisht interesit juridik i percakton funksionari i cili udheheq me organin kompetent për vendimmarrje.

Neni 5

(1) Organi kompetent për vendimmarrje, do ta arketoje kompensimin për deshmie dhe të dhenen e leshuar në emer dhe për llogari të institucionit nga i cili eshte marre deshmia dhe e dhena me detyre zyrtare në lartesine e percaktuar me liste tarifore të percaktuar në perputhje me ligjin.

(2) Sherbimi për marrjen dhe shkembimin e deshmive dhe të dhenave me detyre zyrtare ndermjet organit kompetent për vendimmarrje dhe institucionit nga i cili merret deshmia dhe e dhena, behet pa kompensim.

(3) Për arketimin e kompensimit nga paragrafi (1) i ketij neni, organi kompetent për vendimmarrje i leshon pales vertetim, në të cilin theksohet lloji i kompensimit për deshmie dhe të dhenen e marre me detyre zyrtare, të nevojshem për marrjen e asaj deshmie dhe të dhene.

Neni 6

Aktet nenligjore të parapara me kete ligj do të miratohen në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".